

UDHËZIM
Nr. 2, datë 12.5.2026

**PËR PROCEDURAT, RREGULLAT, ARSYET DHE MËNYRËN E NJOFTIMIT PËR
PEZULLIM NGA ANA E ZOTËRUESIT TË LEJES MINERARE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, nenit 25, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e kriterëve, kushteve dhe procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për pezullim të aktivitetit mineral nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sektorin mineral.

2. Subjekti mineral mund të kërkojë pezullimin e aktivitetit mineral, në rastet kur provohet ekzistenca e një prej rasteve të mëposhtme:

a) Mungesa e tregut për produktin mineral, për shkak të rrethanave ekonomike apo mbylljes së tregjeve përpunuese, që ndikojnë drejtpërdrejt në shitjen e produktit mineral;

b) Rënia e çmimeve të mineralit nën koston e prodhimit, i mbështetur në raportet e tregjeve ndërkombëtare, uljes së cilësisë së mineralit, apo rritjes së kostove të prodhimit;

c) Kushtet e pafavorshme klimatike, veçanërisht në minierat e vendosura në zona të thella malore, të cilat pengojnë zhvillimin normal të aktivitetit mineral;

ç) Mungesa e fuqisë punëtore, veçanërisht në subjektet që operojnë në zona të largëta nga qendrat e mëdha të banuara;

3. Subjekti mineral, nëse kërkon ta pezullojë veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar, sipas përcaktimeve të neneve 18 dhe 25 të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është i detyruar të paraqesë kërkesë me shkrim pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare.

4. Kërkesa e parashikuar në pikën 3, të këtij udhëzimi, përmban:

a) një informacion të hollësishëm mbi arsyet e pezullimit dhe dokumentacionin provues përkatës;

b) periudhën e kërkuar të pezullimit;

c) planin e masave për ruajtjen e zonës minerare gjatë gjithë periudhës së pezullimit.

5. Ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare përcjell për shqyrtim dhe vlerësim kërkesën, së bashku me dokumentacionin shoqërues, pranë strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarisë minerare, e cila shprehet mbi të brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e depozitimit të kërkesës.

6. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarisë minerare, gjatë vlerësimit të kërkesës, kur e çmon të nevojshme për shqyrtimin e plotë të saj, kërkon nga subjekti mineral paraqitjen e informacionit dhe dokumentacionit shtesë për rastet e përcaktuara në pikën 2, të këtij udhëzimi si dhe kur është e nevojshme, kryen verifikime në terren.

7. Subjektit mineral i caktohet një afat jo më i gjatë se 5 (pesë) ditë pune për paraqitjen e informacioneve shtesë të kërkuara sipas pikës 6 të këtij udhëzimi. Periudha nga data e njoftimit të kërkesës për plotësim deri në paraqitjen e informacionit të kërkuar nuk llogaritet në afatin e shqyrtimit të parashikuar në pikën 5 të këtij udhëzimi. Në rast se subjekti mineral nuk paraqet

informacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar, kërkesa shqyrtohet mbi bazën e dokumentacionit të administruar.

8. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe për monitorimin e veprimtarisë minerare, bazuar në të dhënat e depozituara gjatë gjithë aktivitetit minerar për subjektin, që ka kërkuar pezullimin e , të raportuara nga vetë subjekti, si dhe nga monitorimet e kryera në terren, përgatit një përmbledhje të ecurisë së lejes minerare në zotërim të subjektit minerar.

9. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarisë minerare, përgatit një propozim të arsyetuar për miratimin ose refuzimin e kërkesës për pezullim dhe ia përcjell atë ministrit.

10. Ministri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së propozimit të struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarisë minerare, merr vendim për miratim ose refuzim të kërkesës për pezullim të veprimtarisë së shfrytëzimit në zonën e lejuar.

11. Vendimi i njoftohet subjektit minerar, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Autoritetit Kombëtar të Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

12. Gjatë periudhës së pezullimit, subjekti minerar, në përmbushje të detyrimeve të ligjit minerar dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, është i detyruar:

- a) të marrë masa për sigurinë teknike të objektit minerar;
- b) të marrë masa për mirëmbajtjen e objektit minerar;
- c) të respektojë detyrimet për mbrojtjen e mjedisit;
- ç) të ruajë infrastrukturën e zonës minerare;
- d) të raportojë periodikisht pranë autoritetit përgjegjës sipas kërkesave ligjore.

13. Në rast se kushtet për të cilat është miratuar pezullimi i aktivitetit minerar pushojnë së ekzistuari përpara përfundimit të afatit të miratuar, subjekti minerar ka detyrimin që, menjëherë dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i krijimit të kushteve për të punuar, të njoftojë zyrtarisht, ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarisë minerare dhe Agjencinë Kombëtare të Sigurisë dhe Emergjencave Minerare, për rifillimin e aktivitetit minerar.

14. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Agjencia Kombëtare e Sigurisë dhe Emergjencave Minerare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi